



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIJË DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË

Nr. 5731/Prot.

Tiranë, më 30.09.2021

**Lënda:** Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1442 datë 21.10.2009.

**Drejtuar:** SHOQERISË “MARA 2011” SHPK  
Lagjia "Pjetër Budi", Pallati pranë Bashkisë, Burrel, Rrethi Mat

**Për dijeni:** AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**

**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Mara 2011” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1442 datë 21.10.2009, për mineral kromi, në objektin “Stoku i sterileve Gal.B, Zona D”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2776, datë 16.07.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1442, datë 21.10.2009, për mineral kromi, në objektin Stoku i sterileve Gal.B, Zona D”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sepse në objekt nuk punohet prej më shume se një vit kalendarik si dhe nuk keni miratuar programin vjetor të punës në AKBN.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit nr.1442 datë 21.10.2009, për mineral kromi, në objektin Stoku i sterileve Gal.B, Zona D”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1442 datë 21.10.2009, për mineral kromi, në objektin Stoku i sterileve Gal.B, Zona D”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

